

Në bazë të nenit 75 alinea 2 nga Ligji për mbrojtje nga zjarri dhe shpëtim (gazeta zyrtare e RM NR. 93 e vitit 2012), dhe në bazë të Udhëzimit për përmbajtjen e Rregullores për mbrojtje nga zjarret dhe shpërthimet (Gazeta zyrtare 80/2011), Bordi i Universitetit të Evropës Juglindore, rr. Ilindenska nr. 335 Tetovë, në mbledhjen e mbajtur më 18 .11.2016 solli këtë:

RREGULLORE PËR MBROJTJE NGA ZJARRET DHE SHPËRTHIMET

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me rregulloren për mbrojtje nga zjarri dhe shpërthimet rregullohet organizimi për mbrojtje nga zjarri, caktohen dhe zbatohen masat për mbrojtje nga zjarri, procedura në rast të zjarrit si dhe të drejtat dhe detyrat e të punësuarve në zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri dhe shpërthimet.

Neni 2

Organizimi dhe zbatimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpërthimet bëhet në bazë të Ligjit për shpëtim, Ligjit për zjarrfikje, Vlerësimit për rrezik nga fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera, Planit për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera dhe të dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Punët për mbrojtje nga zjarri janë me interes të përbashkët për Universitetin e Evropës Juglindore si tërësi dhe ato organizohen e zbatohen njësoj në të gjitha objektet dhe hapësirat e UEJL.

Neni 4

UEJL -Tetovë, e ka detyrim t'i mbrojë nga zjarri edhe objektet dhe hapësirën që kufizohen me Universitetin.

Neni 5

Planin për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, janë të detyruar ta zbatojnë të gjithë të punësuarit në UEJL -Tetovë, pavarësisht a janë në marrëdhënie të rregullt pune ose me kohë të caktuar, si dhe të gjithë studentët dhe personat tjerë, të cilët pa marrë parasysh se në çfarë baze gjenden ose qëndrojnë në rrethin ose hapësirat e objekteve të Universitetit.

1. VENDOSJA ORGANIZATIVE, FUNKSIONALE DHE HAPËSINORE E UEJL

Neni 6

UEJL gjendet në Rr. Ilindenska nr. 335 - Tetovë edhe në rr. Arkiepiskop Angelari – Shkup.

Për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri, në objektet dhe hapësirat (zyra, klasa, amfiteatro, salla e sporteve, laboratorë, dhomat e studentëve dhe hapësirat tjera afariste) të Universitetit, është formuar Shërbimi profesional, i cili përbëhet nga Bordi i Universitetit, Rektori i Universitetit, Shërbimi për sigurim dhe të punësuar të tjerë.

2. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E TË PUNËSUARVE

Bordi i Universitetit

Neni 7

Bordi i Universitetit i kryen detyrat në vijim:

- Sjell Rregulloren për mbrojtje nga zjarret dhe shpërthimet, rendin shtëpiak zjarrfikës dhe vendimin për të punësuarit e Universitetit.

- I cakton financat e nevojshme për sigurimin e mjeteve dhe pajimeve për mbrojtje nga zjarret dhe shpërthimet dhe e miraton shfrytëzimin e tyre.

- Pranon raportin për gjendjen në Universitet, për mbrojtje nga zjarri dhe për shkallën e sigurisë dhe i ndërmerr masat e nevojshme për përparimin e mbrojtjes.

- Bën edhe punë dhe detyra të tjera që kontribuojnë për përparimin e mbrojtjes nga zjarret dhe shpërthimet.

Rektori i Universitetit

Neni 8

Rektori i ka këto të drejta dhe detyra:

- Është përgjegjës për organizimin e mbrojtjes nga zjarret dhe shpërthimet në UEJL edhe për zbatimin e masave të caktuara për mbrojtjen nga zjarret dhe shpërthimet.

- I shqyrton raportet, rekomandimet dhe mendimet e organeve inspektuese dhe lidhur me to sjell vendime përkatëse.

- Sjell vendime për kryerjen e detyrimeve individuale nga shërbimet profesionale nga lëmi i përgatitjeve të mbrojtjes kundër zjarreve të caktuara me Ligjin për mbrojtje dhe shpëtim, Ligjin për zjarrfikje dhe aktet tjera nënligjore të UEJL –Tetovë.

- Jep mbështetje për trajnimin e të punësuarve me rastin e kryerjes së detyrave nga lëmi i mbrojtjes së zjarreve dhe shpërthimeve.

- Sjell Vendim për largimin e padrejtësive dhe dukurive të cilat mund të shkaktojnë zjarr ose ta rrezikojnë jetën e studentëve, të të punësuarve, të personave të tjerë dhe pasurisë.

- Ngre procedurë kundër të punësuarve përgjegjës për moszbatimin dhe mosrespektimin e masave për mbrojtje nga zjarret dhe shpërthimet.

Shërbimi për sigurim i Universitetit

Neni 9

Shërbimi për sigurim i universitetit i kryen këto detyra:

- I ndjek masat preventive për mbrojtje nga zjarret të caktuara me ligj dhe me akte të tjera nga kjo lëmi.

- E përgatit planin për mbrojtje nga zjarret dhe shpërthimet dhe kujdeset për zbatimin e tij në nivel të Universitetit.

- I ndjek dispozitat na lëmi i mbrojtjes nga zjarret dhe shpërthimet, si dhe të arriturat teknike nga kjo fushë dhe në përputhje me këtë propozon dhe ndërmerr masa konkrete për përparimin e mbrojtjes nga zjarret dhe shpërthimet.

- Në rast të paraqitjes së zjarrit ose shpërthimit drejtpërsëdrejti merr pjesë në zbulimin e shkaqeve për paraqitjen e zjarrit ose të shpërthimit.

- E zbaton Ligjin për mbrojtje dhe shpëtim dhe dispozitat tjera nga lëmi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpërthimet gjatë projektimit, ndërtimit, meremetimit dhe mbindërtimit e adaptimit të objekteve dhe hapësirave.

- Siguron për të gjitha objektet dhe hapësirat pajisje përkatëse teknike dhe mjete për fikje të zjarrit, varësisht nga shkalla e rrezikut.

- Kujdeset që pajisja zjarrfikëse të jetë në gjendje të rregullt dhe të ketë qaje e të vendoset në vende ku duket.

- Dukshëm i shënon hidrantet dhe vendet e aparateve për fikjen e zjarrit.

- Në hapësirat e punës siguron pajisje përkatëse për fikjen e zjarrit, ndërsa të punësuarit në ato hapësira i aftësojnë që ta përdorin pajisjen dhe ta shfrytëzojnë ashtu siç është parashikuar të përdoret.

- Kujdeset që të gjitha klasat, zyrat, hapësirat ndihmëse, shkallët, korridoret dhe hapësirat tjera të ngjashme gjithmonë të jenë të liruara nga të gjitha sendet dhe gjërat që mund të shkaktojnë zjarr ose paraqesin pengesë për lëvizje të lirë në këto hapësira.

- Kujdeset që aparatet dhe instalimet elektrike në të gjitha objektet dhe hapësirat gjithmonë të jenë në rregull dhe të vendosura sipas rregullave.

- Në vend të dukshëm vendos shënjime për ndalimin e pirjes së duhanit, futjes së zjarrit të hapur dhe të eksplozivëve.

- Kujdeset për daljet dhe vendkalimet për evakuim të studentëve, të të punësuarve, të personave të tjerë dhe pasurisë, që ato gjithmonë të jenë të lira për hyrje-dalje.

Të punësuarit tjerë

Neni 10

Të punësuarit i kanë detyrimet në vijim:

- Përgjegjësi për gjendjen me mbrojtjen nga zjarret dhe shpërthimet në Universitet.

- Në fushëveprimin e punës së tyre e kontrollojnë dhe e organizojnë mbrojtjen me çka i ruajnë studentët dhe pasurinë e Universitetit.

- Angazhohen dhe marrin masa për zbatimin konsekuent të masave të caktuara dhe të dala nga urdhrat për mbrojtje nga zjarret dhe shpërthimet.

- Në rast se vërehen mangësi, marrin masa për largimin me kohë të mangësive.
- Aftësohen dhe bëjnë verifikimin e njohurive për mbrojtje nga zjarret.
- E ndjekin punën e të gjitha aparateve, instalimeve dhe pajisjeve të tjera dhe çdo parregullsi e lajmërojnë te përgjegjësi.
- Kujdesen që qasja në vendet e tyre të punës të jetë përherë e lirë.
- T'i përdorin me kujdes materiet dhe materialet e rrezikshme dhe marrin masa për mbrojtje me rastin e përdorimit të tyre.
- Përdorin pajisje dhe mjete personale për mbrojtje.
- Lajmërojnë për paraqitjen e zjarrit ose shpërthimit dhe marrin pjesë në lokalizimin dhe evitimin e rrezikut nga ata.
- Bëjnë evakuimin e studentëve, të punësuarve dhe MTS sipas planit të evakuimit.
- Pas mbarimit të kohës së punës të punësuarit janë të detyruar t'i shkyçin aparatet elektrike të cilat mund të shkaktojnë zjarr.
- Bëjnë edhe punë të tjera të cilat kontribuojnë për përparimin e mbrojtjes nga zjarret dhe shpërthimet.

Neni 11

Si shkelje serioze të kësaj rregulloreje konsiderohet:

- Mospjesëmarrja në zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri, evakuimi i studentëve dhe i të punësuarve dhe shpëtimi i vendit të vet dhe në objekte.
- Mospjesëmarrja në fikjen e zjarrit dhe në shpëtimin e pasurisë dhe njerëzve dhe në largimin e pasojave të shkaktuara nga zjarri.
- Mospasja kujdes për rregullsinë e aparateve, pajisjeve teknike dhe mjeteve për mbrojtje nga zjarri.
- Mospasja kujdes për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pajisjes personale dhe kolektive të cilën e posedojnë objektet dhe të punësuarit për mbrojtje nga zjarri.
- Moslargimi ose moslajmërimi i çfarë do defekti ose dëmtimi i instalimeve elektrike, aparateve elektrike etj. nga të cilat mund të shkaktohet zjarri.
- Moslajmërimi i të punësuarve dhe mosmarrja e masave urgjente për shpëtim dhe për fikjen e zjarrit në rast të paraqitjes së zjarrit.
- Moszbatimi i masave për mbrojtje nga zjarri si dhe moskryerja e detyrimeve lidhur me mbrojtjen nga zjarri nga ana e të punësuarve në hapësirat punuese të Universitetit.
- Moskryerja e detyrimeve nga ana e personave që punojnë në Universitet.

- Mosrespektimi i urdhrave të udhëheqësit të aksionit për fikjen e zjarrit në rast të paraqitjes së zjarrit.

- Mosrespektimi i masave për mbrojtje nga zjarri ose shkaktimi i qëllimshëm i zjarrit ose kryerja e sabotimit dhe obstrukcioneve nga aspekti i mbrojtjes nga zjarret.

Aparatet, mjetet teknike dhe pajisjet për mbrojtje nga zjarri

Neni 12

Rektori i Universitetit, si bartës mbrojtjen nga zjarret dhe shpërthimet, kërkon nga shërbimet kompetente të sigurojnë mjete dhe pajisje teknike për fikjen e zjarrit për objektin e tyre. Lloji, sasia e aparateve dhe pajisjeve për fikjen e zjarrit duhet t'i përgjigjen shkallës së rreziqeve nga zjarri llogaritur sipas ngarkesës së zjarrit në Universitet nëpër objekte, e të cilat janë caktuar me Vlerësimin e rrezikimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Planin për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera edhe në këtë rregullore.

Neni 13

Universiteti disponon me sisteme përkatëse, me aparate e instalime automatike dhe zbulimin manual dhe alarmimin për paraqitjen e zjarrit, aparate dhe instalime për detektim, mjete për fikje zjarresh, aparate kundër zjarresh, rrjetë hidrantësh nëntokësorë e të mureve dhe pajisje tjetër zjarrfikëse.

Universiteti të vendosë dhe të sigurojë një sistem qendror në shërbim të sigurimit të lajmërimit të të punësuarve, vizitorëve dhe të studentëve për zjarrin eventual dhe nevojën për braktisjen e objektit - evakuimin, përmes shpalljes me altoparant në të gjitha objektet dhe duhet të vendosen Drita paniku dhe udhërrëfyes për evakuim në të gjitha objektet në daljet nga hapësirat dhe objektet.

Neni 14

Aparatet, instalimet, aparatet zjarrfikëse, mjetet për fije janë në përputhje me dispozitat, përfshirë këtu edhe me standardizimin.

Neni 15

Shtypja dhe sasia e nevojshme e ujit sigurohet me aparatën për rritjen e shtypjes.

Aparati për rritjen e shtypjes është siguruar me burim rezervë të energjisë elektrike, pra me agregatin i cili gjendet në objektin 900 dhe vihet në veprim në mënyrë automatike kur ndalet energjia elektrike.

Neni 16

Rrjeta e hidrantëve nuk vendoset në objekte ose në hapësira në të cilat shfrytëzimi i ujit si mjet fikjeje mund të sjell rreziqe plotësuese ose në reaksion me disa materie të shkaktojë zjarr ose shpërthim.

Kritere minimale e pajisje teknike dhe mjete për fikje

Neni 17

Me kritere minimale për vendosje dhe mjete e pajisje minimale për fikje të zjarrit në kuptimin e kësaj rregulloreje nënkuptohet minimumi i objekteve (hapësirave) për vendosjen e studentëve, të punësuarve dhe të pajisjeve dhe minimumi i pajisjes zjarrfikëse, i veglave dhe mjeteve për fikje të zjarrit dhe i shpëtimit të jetës së studentëve, të punësuarve dhe pasurisë nga zjarri dhe i sasisë së nevojshme të

rezervave të pajimeve përkatëse teknike, veglave dhe mjeteve për fikje të zjarrit të cilat Universiteti i posedon.

Neni 18

Për vendosjen e studentëve dhe të punësuarve, sistemet për zbulim dhe alarmim të zjarrit, pajisjet teknike, veglat dhe mjetet tjera për fikje, Universiteti siguron objekte të veçanta ose hapësira të tilla nëpër objekte.

Neni 19

Pajisja minimale teknike dhe mjetet për fikjen e zjarrit përcaktohet sipas shkallës së rrezikimit nga zjarri, lloji i objektit që mbrohet.

Universiteti disponon me pajisjen teknike si vijon:

1. AZF S -9 -148 c;
2. AZF CO2-5 -2 c; krahas tabelave dispeçere
3. AZF S-50-5c
4. AZF FM200 5c
5. Hidrantë nëntokësorë -19 p (pajisje e pakompletuar hidrantësh)

Krahas Pajisjes dhe mjeteve zjarrfikëse dhe mjeteve për fikjen e zjarreve Universiteti duhet të sigurojë edhe pajisje rezervë ZF dhe mjete për fikjen e zjarreve.

Vërejtje:

- Për objektet që nuk kanë vendosur shkallë ZF, Universiteti ka shkallë mobile për fikje zjarri
- Eko plaf për fikjen e zjarrit që përfshin njerëzit për çdo objekt nga 5-10 c.
- Pajisja me hidrantë është vendosur në objektin 900.

Neni 20

Në përputhje me procesin teknik, mënyra bashkëkohore e projektimit dhe ndërtimit të objekteve dhe zbatimi i materialeve bashkëkohore për ndërtim, Universiteti do t'i zbatojë dhe do t'i inkorporojë sistemet, instalimet, pajisjet dhe mjetet e reja, bashkëkohore për mbrojtje nga zjarri.

Neni 21

Aparatet dhe pajisjet për fikje gjenden në hapësirat e objekteve në vendet më të ndritshme, ku është më i madh rreziku nga paraqitja e zjarrit dhe ato të shënohen dukshëm e të kenë qasje.

Rrjeta e hidrantëve është bërë asisoj që në rast të fikjes së zjarrit ka sasi të mjaftueshme të ujit.

Neni 22

Për fikjen fillestare të zjarrit Universiteti ka hidrantë zjarrfikës aparate manuale zjarrfikëse.

Neni 23

Shërbimi për sigurim ose personi i caktuar bën për çdo ditë verifikim vizual dhe kujdeset për rregullsinë e AZF, rrjetën e hidrantëve dhe hidrantëve ZF për afatin e përdorimit të aparateve zjarrfikëse dhe pajisjeve për fikjen e zjarrit. Çdo defekt që paraqitet te hidrantët ZF dhe te aparatet ZF, duhet të mënjanohet sa më shpejt, si me mbushje, ndreqje ose remont nga ana e personave profesionistë.

Për çdo aparat ose pajisje mbahet evidencë me shkrim.

Neni 24

Lajmëruesit automatikë dhe manualë të zjarrit e dritat e panikut e elektriciteti statit (tokëzimi), verifikohen një herë në vit ose sipas nevojës.

Instalimi rrufepritës verifikohet për çdo dy vjet ose pas dëmtimit eventual.

Organizimi për mbrojtje nga zjarret

Neni 25

Për shkak të përparimit dhe të zbatimit të masave preventive nga zjarri, fikja e zjarrit dhe shpëtimi i njerëzve dhe i pasurisë që rrezikohen nga zjarri caktohet një person ose formohet një shërbim për mbrojtje nga zjarri dhe shpërthimet.

Procedura në rast të zjarrit

Neni 26

Çdo i punësuar ose ndonjë person tjetër i cili do të vërejë rrezikun e drejtpërdrejtë nga paraqitja e zjarreve ose që do ta vërejë zjarrin. Ka të drejtë dhe detyrim ta mënjanojë rrezikun, përkatësisht ta fikë zjarrin, nëse këtë punë mund ta bëjë pa rrezikuar veten ose ndonjë person tjetër.

Nëse i punësuari nuk mund ta mënjanojë rrezikun përkatësisht ta fikë zjarrin, është i detyruar që menjëherë ta njoftojë Shërbimin për sigurim të Universitetit në tel. 044 356 200 dhe duhet t'i japë të dhënat e kërkuara dhe të kërkojë ndihmë nga të punësuarit të cilët janë në një afërsi të drejtpërdrejtë.

I punësuari është i detyruar t'i qaset menjëherë fikjes së zjarrit me mjetet të cilat i ka në disponim (Hidrantë ZF dhe aparate ZF etj.).

Zjarrin te Njësia zjarrfikëse e paraqet Shërbimi për sigurim i Universitetit në tel. nr. 193 dhe hep hollësi për vendin e zjarrit, madhësinë e zjarrit, drejtimin e zgjerimit dhe llojin e materialit që digjet, mundësisht sasinë e tij dhe nëse ka persona të lënduar, numrave i të lënduarve (nëse ka) etj.

Pas ardhjes së njësisë zjarrfikëse aksionin për fikje të zjarrit e udhëheq personi përgjegjës (i Njësisë zjarrfikëse) për mbrojtjen nga zjarret ose një person tjetër të cilin e cakton ai.

Shërbimi për sigurim i Universitetit, menjëherë pas pranimit të zjarrit duhet t'i njoftojë personat të cilët gjenden në objektin e Universitetit dhe e fillon aksionin për evakuim dhe shpëtim dhe fikje të zjarrit.

Personi përgjegjës i mbrojtjes kundër zjarrit vendos sa persona do të marrin pjesë në fikjen e zjarrit, e sa në shpëtimin e studentëve, të të punësuarve dhe të pasurisë së rrezikuar nga zjarri.

Po të ketë nevojë për ndihmë thirret në ndihmë Njësia e zjarrfikësve të qytetit dhe ndihma urgjente mjekësore nga Tetova.

Të punësuarit të cilët marrin pjesë në fikjen e zjarrit janë të detyruar t'u përmbahen urdhrave të udhëheqësit të aksionit për fikjen e zjarrit.

Të punësuarit që nuk marrin pjesë në fikjen e zjarrit janë të detyruar që në një rrugë sa më të shkurtër, pa panik dhe pa penguar fikjen e zjarrit janë të detyruar që përmes rrugës më të shkurtër pa panik dhe pa e penguar fikjen dhe shpëtimin ta braktisin vendin e rrezikuar nga zjarri.

Të punësuarit në sigurimin e objektit u bëjnë kontroll në hyrjet e objektit ku është paraqitur zjarri njerëzve dhe automjeteve që vijnë për shkak të fikjes së zjarrit, nuk lejojnë qasje për njerëzit e pathirrur në objektet ku ka ndodhur zjarri dhe në mënyrë aktive marrin pjesë në mbajtjen e rendit dhe sigurisë gjatë kohës sa zgjat zjarri.

Masa për mbrojtje nga zjarri dhe shpërthimi me të cilat mënjanohet, përkatësisht zvogëlohet rreziku nga zjarri dhe shpërthimet

Neni 27

Masat dhe aktivitetet e planifikuara shërbejnë për pamundësimin e paraqitjes së zjarreve e shpërthimeve, për kufizimin e zgjerimit të zjarrit, shpërthimit dhe për pasojat, zvogëlimin e rreziqeve, përmes sistemit të masave preventive dhe represive.

Neni 28

Masat preventive të cilat planifikohen dhe zbatohen me planifikimin hapësinor dhe urbanistik dhe me zbatimin e normativave dhe standardeve ndërtimore me rastin e projektimit dhe ndërtimit të objekteve.

Masa preventive janë aktivitetet për zbulimin, pengimin e zgjerimit fikjen e zjarreve, si dhe dhënia e ndihmës gjatë mënjanimin të pasojave.

Neni 29

Si masa preventive për mbrojtje nga zjarri, në kuptimin e kësaj rregulloreje konsiderohen masat e përmendura në Planin dhe Vlerësimin për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, mbrojtja nga zjarri dhe shpërthimi.

Përmbajtja e këtij dokumentacioni për mbrojtje nga zjarret përbëhet nga një vlerësim e analizë e hollësishme nga rreziqet nga zjarri dhe shpërthimi në raport me qëllimin dhe funksionin që ka objekti, arkitektura, materiali i përdorur dhe konstruksionet e zbatuara, vetitë e materieve që shfrytëzohen në procesin e punës, vetitë e materialeve dhe materieve që janë depozituar dhe mënyra e kushtet e depozitimit dhe në bazë të kësaj parashihen dhe realizohen masat për mbrojtje nga zjarri dhe shpërthimi.

Masat ndërtimore-konstruktive zjarrfikëse

Neni 30

Masat urbanistike dhe ndërtimore-konstruktuese ZF Universiteti i zbaton për shkak të zvogëlimit ose pengimit të rrezikut nga paraqitja dhe zgjerimi i zjarrit dhe shpërthimit.

Masat ndërtimore-konstruktuese janë përkufizuar me projektimin dhe realizimin e sektorëve zjarrfikës, mureve kundër zjarreve, dyerve kundër zjarreve, dyerve kundër zjarreve dhe të çelave, shkallëve kundër zjarreve dhe të çelave e rrugëve të shpejta për evakuim. Qasja dhe komunikimi i automjeteve zjarrfikëse deri te secili objekt është siguruar nga të gjitha anët e objekteve.

Gjatë rikonstruktimit ose ndërtimit të objekteve, Universiteti do të veprojë në pajtim me Ligjin për ndërtim dhe rikonstruktim.

Masat elektroenergjetike dhe termoenergjetike ZF

Neni 31

Universiteti do t'i zbatojë më pajtim me ligjin që domethënë masat e parapara dhe mënyrën përkatëse të realizimit të instalimeve elektrike me çka do të zvogëlohen rreziqet e paraqitjes dhe zgjerimit të zjarrit ose shpërthimit.

Neni 32

Çdo objekt ka tabelën e vet elektrodishpeçere prej nga me ndihmën e ndërprerësit kryesor ndërpritet hyrja në të gjitha tabelat dishpeçere, në tabelat komanduese dhe te konsumatorët nëpër objekte.

Tabelat kryesore elektrodishpeçere janë furnizuar me ndërprerës automatikë për ta ndërprerë hyrjen e energjisë elektrike.

Ndërprerësit vendosen në vende të përshtatshme për ndërprerje të shpejtë dhe të lehtë të tensionit nga ana e të punësuarve në rast të zjarreve ose të ndonjë rreziku tjetër.

Neni 33

Për sigurimin dhe furnizimin e vazhdueshëm me energji elektrike në nyjat kritike siç janë: pompat për sigurimin e ujit, ndriçimi siguruës, sistemet për zbulim automatik dhe për lajmërimin e zjarrit në dhomën e serverit etj. universiteti siguron burime rezervë të energjisë me agregate.

Neni 34

Konektorët dhe konsumatorët (në dhomën e serverit ose në objekte të tjera), janë realizuar me S siguroese në përputhje me rregullat e standardet teknike.

Në objektet dhe hapësirat dhe në zonat e tyre të rrezikut nga zjarri, në të cilët ka aparate, pajisje, instalime etj, që mund të krijojnë elektricitet, janë tokëzuar për së mbari.

Neni 35

Instalimet, konektorët, aparatet dhe konsumatorët tjerë rregullisht mbahen në gjendje të rregullt në përputhje me dispozitat teknike dhe me udhëzimet e prodhuesit si dhe me rregullat e praktikës teknike.

Neni 36

Të gjitha objektet dhe hapësirat detyrimisht duhet të sigurohen me ajrosje natyrore ose artificiale.

Neni 37

Të gjitha objektet të sigurohen me instalime rrufepritësish për mbrojtje nga zbrazjet atmosferike të bërë në përputhje me dispozitat teknike për rrufepritës.

Neni 38

Për shkak të zvogëlimit të rrezikut nga paraqitja dhe zgjerimi i zjarrit të paraparë me masa të përgjithshme preventive në formë të shenjave për të shenjave për kumtim, rrezik dhe ndalime, shenja për caktimin e drejtimit të lëvizjes dhe daljet me rastin e evakuimit të cilat janë vënë në vend të dukshëm nëpër objekte.

Neni 39

Masat për mbrojtje nga zjarret dhe shpërthimet janë:

- Zgjedhja e materialeve, aparateve, instalimi dhe konstruksioni i objekteve me të cilët do të pengohet zjarri dhe mundësia e zgjerimit të zjarrit dhe shpërthimeve do të reduktohet në minimum
- Ndërtimi i rrugëve dhe vendkalimeve të natyrshme për qasje të lehtë nëpër objekte
- Sigurimi i sasive të mjaftueshme të ujit ose të mjeteve dhe aparateve të tjera për fikjen e zjarrit.
- Ndalimi i përdorimit të zjarrit të hapur dhe u burimeve të tjera të ndezjes nëpër objekte dhe në hapësirat e UEJL- Tetovë, për shkak të së cilave mund të shkaktohet zjarr ose shpërthim
- Ndalimi i përdorimit të stufave elektrike, ngrohtave, stufave me gaz dhe trupa të tjerë ngrohës si dhe depozitimin e materieve që ndizen lehtë në hapësirat e punës të Universitetit në të cilat mund të shkaktojnë zjarr ose shpërthim.
- Në çdo objekt dhe në çdo kat në vende të dukshme të vendoset Udhëzimi për evakuim për braktisjen e sigurt të objektit.

Neni 40

Universiteti është i organizuar në atë mënyrë që rreziku nga zjarri dhe shpërthimi të reduktohet në minimum.

Në objektet dhe hapësirat e Universitetit ku zhvillohet mësimi për studentët medoemos duhet të vendosen aparate e pajisje për zbulimin e shpejtë dhe për fikjen e zjarrit.

Neni 41

Instalimet elektrike, ventiluese, ngrohëse dhe rrufepritëse e instalime të tjera të ngjashme duhet patjetër të vendosen në përputhje me normativat dhe standardet teknike dhe të mbahen në gjendje të rregullt.

Neni 42

Aparatet, veglat dhe pajisjet për fikjen e zjarrit të ruhen në vende ku qasja është e lehtë dhe të jenë të dukshme dhe në vende të caktuara për këtë qëllim dhe këto të ruhen në gjendje të mirë.

Neni 43

Aparatet zjarrfikëse shfrytëzohen vetëm për fikjen e zjarrit ose për aftësimin e të punësuarve. Në të gjitha rastet tjera aparatet dh pajisja zjarrfikëse nuk guxojnë të shfrytëzohen.

Neni 44

Pas mbarimit të orarit të punës aparatet elektrike dhe aparatet tjera që mund të shkaktojnë zjarr ose shpërthim duhet të shkyçen.

3. MËNYRA E NJOHJES SË TË PUNËSUARVE ME RREZIQET NGA ZJARRI DHE SHPËRTHIMI PËR VENDET E PUNËS ME RASTIN E HYRJES NË PUNË OSE ME RASTIN E NDËRRIMIT TË VENDIT TË PUNËS

Neni 45

Universiteti do t'i informojë të gjithë të punësuarit dhe të sapopunësuarit dhe studentët me rreziqet dhe masat preventive për mbrojtje nga zjarri dhe shpërthimi, si dhe të drejtat e detyrimet nga aspekti i mbrojtjes nga zjarret dhe shpërthimet. Njohjen dhe edukimin e organizon dhe e zbaton Rektori i UEJL, me një plan të caktuar dhe të miratuar paraprakisht, e mund të thirret edhe ndonjë firmë profesionale ose ndonjë person nga jashtë.

- Njohja dhe edukimi nga aspekti i Mbrojtjes nga zjarri është e drejtë dhe detyrim i çdo të punësuarit dhe i çdo të pranishmi dhe është në interes të UEJL.

- Njohja e të punësuarit me rreziqet bëhet në këtë mënyrë:

Punëdhënësi është i detyruar që të punësuarit t'ia japë në shqyrtim të gjitha rregulloret dhe akteve ligjore me të cilat rregullohet kjo materie.

- Përgjegjësi në UEJL është i detyruar para se të hyjë i punësuarit në vendin e punës me gojë t'ia bëjë me dije me gojë për rreziqet nga paraqitja e zjarrit dhe shpërthimit si dhe t'ia bëjë me dije të drejtat dhe detyrimet e tij.

- Përgjegjësi në UEJL bë me dije për rreziqet dhe pasojat të cilat mund të paraqiten me përdorimin e pandërgjegjshëm e je të drejtë me mjetet e punës.

4. MËNYRA E AFTËSIMIT TË TË PUNËSUARVE PËR PJESËMARRJE NË FIKJEN E ZJARREVE, PËRDORIMIN E APARATEVE, PAJISJEVE TEKNIKE DHE MJETEVE PËR FIKJEN E ZJARRIT

Neni 46

Të punësuarit në UEJL-Tetovë, aftësohen dhe trajnohen për zbatimin e masave preventive dhe represive për mbrojtje nga zjarri, për fikjen e zjarreve fillestare dhe procedurën e në rast zjarri, si dhe për shpëtim dhe evakuim. Trajnimi bëhet përmes ligjëratave teorike dhe praktike (trajnim), ndërsa pastaj bëhet edhe testim i çdo të punësuarit në vend të punës të cilët pas njohurive pozitive marrin vërtetim (certifikatë) se është aftësuar nga fusha e MNZ (mbrojtje nga zjarret). Nëse dikush nga të punësuarit tregon njohuri të pamjaftueshme me rastin e trajnimit dhe testimit, trajnimi përsëritet në një afat jo më të vogël se 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, dhe në qoftë se edhe atëherë nuk tregon njohuri të mjaftueshme (rezultate) konsiderohet se i punësuarit nuk i plotëson kushtet për punë

Gjatë trajnimit duhet të përfshihet materia në vijim:

1. Kushtet për djegie dhe fikje;
 2. Masat preventive për MNZ dhe rreziqet në vend të punës dhe
 2. Pajisjet dhe mjetet (AZF – aparatet zjarrfikëse - dhe hidrante).
 3. Shpëtimi dhe evakuimi
- Njohuria nga lëmenjtë e sipërpërmendur të verifikohet njëherë në dy vjet.

Të punësuarit të jenë të aftësuar për realizimin e masave preventive për mbrojtje nga zjarret dhe mënyrën për përdorimin e aparateve zjarrfikëse dhe për hidrantët.

Krahas aftësisë për fikje, të punësuarit janë të aftësuar edhe për evakuimin e studentëve nga objektet dhe hapësirat e Universitetit në rast të zjarrit etj.

- Nëpër objekte dhe nëpër hapësirat e Universitetit ka drita paniku dhe janë vendosur tabela për udhërrëfime për dalje për evakuimin më të shpejtë të njerëzve;
- Në rast të paraqitjes së zjarrit menjëherë të fiket rryma elektrike nga çelësi kryesor.

5. ORARI DHE KOHA E KONTROLLIMIT TË APARATEVE, PAJISJA TEKNIKE DHE MJETET PËR FIKJEN E ZJARRIT

Neni 47

Sipas karakteristikave ndërtimore e konstruktuese të materialeve, natyra dhe lloji i pajisjeve, që shfrytëzohet në punë, llojet e mundshme të zjarrit janë paraparë dhe janë vendosur aparate për fikjen fillestare të zjarrit.

Fikja është një proces ku me veprim të mjeteve të caktuara për fikje përgjithmonë ndërpritet djegia e materies së ndezur.

Fikja efikase varet shumë nga mjetet e zgjedhura drejtë e adekuate.

Pa marrë parasysh madhësinë e rrezikut nga paraqitja e zjarrit, Universiteti është i pajisur me pajisjen më të domosdoshme për fikjen e zjarreve.

Lloji dhe sasia e pajisjes dhe mjeteve të domosdoshme për fikje të zjarreve caktohen në bazë të dispozitave dhe normativave teknike dhe në bazë të vlerësimit për rrezikim nga zjarri dhe shpërthim.

Rektori-bartësi për mbrojtje nga zjarret në kompetencat e të cilit është zgjedhja e pajisjes dhe mjeteve mban llogari me rastin e zgjedhjes së pajisjes dhe këto t'u përgjigjen standardeve që janë në përdorim të kësaj kohe.

Për fikjen fillestare të zjarreve në objektet dhe hapësirat e Universitetit janë siguruar pajisjet zjarrfikëse në vijim:

HIDRANTE ZJARRFIKËSE: Shërbejnë për fikjen fillestare të zjarreve me ujë. Ato mund të jenë:

- Hidrante muri; Hidrante nëntokësore dhe hidrante mbitokësore: Më së shpeshti janë me diametër prej 52f, 75f, (110f shumë më rrallë).

UJË--: Uji, mund të përdoret me një çurg të plotë, me çurg stërpikës, mjegull uji dhe freskore uji. S- (pluhur zjarrfikës): Aparatet të mbushura me mjet universal për fikje zjarri – pluhur për fikjen e zjarrit fillestar. Si mjet për fikje përdoret pluhuri hidrofob, i cili hidhet me presion dhe ky nuk e përçon rrymën elektrike. Fikin me gulfatje (largimin e oksigjenit nga vendi i zjarrit nën 16%. Fikin instalime dhe aparate elektrike me tension deri më 1000 voltë. Më së miri i fikin materiet djegëse të cilat nuk bëjnë prush. CO₂- -: Aparatet me mbushje CO₂, janë ideale për fikje në zjarreve më të vogla në hapësirë të mbyllur, veçmas te instalimet elektrike, centralet telefonike, qendrat kompjuterike etj.

Neni 48

Aparatet, instalimet dhe pajisja zjarrfikëse servisohen dhe kontrollohen më së paku një herë në vjet kur janë vënë në kushte dhome, përkatësisht dy herë në vjet në se u ekspozohen ndikimeve atmosferike, në pajtim me normativat, standardet dhe udhëzimet teknike të prodhuesit.

Për servisimin, kontrollin testimin, matjen dhe kalibririmin e bërë, servili i autorizuar përgatit procesverbal në të cilin janë shënuar rezultatet nga aktivitetet e bëra.

Neni 49

Defektet e pajisjeve dhe instalimeve të përmendura eliminohen në një afat i cili nuk është më i gjatë se dy ditë nga dita e konstatimit të defektit. Në raste të jashtëzakonshme për shkaqe objektive ky afat vazhdohet në përputhje me mundësitë të servisit të autorizuar i cili e bën servisimin dhe furnizuesi i mjeteve dhe pajisjeve rezervë.

Instalime stabile për zbulim automatik dhe manual dhe për alarmim të zjarrit

Neni 50

Aparatet dhe instalimet stabile për mbrojtje nga zjarret për zbulimin automatik dhe manual dhe për alarmim, duhet të instalohen nëpër objekte, të vendosen në pajtim me normativat, standardet teknike dhe me udhëzimet e me rekomandimet e prodhuesit.

Neni 51

Aparatet automatike dhe manuale dhe instalimet për zbulimin dhe alarmimin e zjarrit të jenë të pajisur me detektorë të ndryshëm: optikë, termikë, jonizues, detektorë flake dhe detektorë për matjen e përqendrimit të gazit në varësi nga rreziqet..

Sistemet zbulimin automatik dhe manual dhe për alarmimin e zjarrit detyrimisht duhet të sigurohen me një burim të pavarur të energjisë.

Neni 52

Sistemet manuale dhe automatike për lajmërim kontrollohen a janë në rregull një herë në vit.

Aparatet zjarrfikëse

Neni 53

Aparatet zjarrfikëse në Universitet vendosen në të gjitha objektet në vendosen në vende të caktuara të hapura.

Lloji dhe sasia e aparateve zjarrfikëse caktohet sipas shkallës së zjarrit, sipërfaqes së objektit dhe ngarkesës së tij me zjarr.

Në çdo aparat zjarrfikës ka një karton kontrollues me të dhëna të veçanta.

Në trupin e aparatit tekstualisht dhe ilustrativisht është përshkruar mënyra e përdorimit.

Në çdo aparat zjarrfikës ka një etiketë me shenja të mjetit për fikje me të cilin është mbushur. Sasia e mjetit, shkallët e zjarrit për të cilin është paraparë dhe udhëzimi për aktivizim.

Aparatet zjarrfikëse vendosen në vende të dukshme dhe me qasje të lehtë ose në afërsi të drejtpërdrejtë të vendeve dhe pajisjeve me rrezik të lartë nga paraqitja e zjarrit në një lartësi prej 1,5 m nga dyshemeja deri te dorëza e aparatit zjarrfikës, ndërsa mbi të vendoset tabela me mbishkrim aparatit zjarrfikës (AZF).

Rrjeta e hidrantëve zjarrfikës

Neni 54

Objektet dhe disa vende të hapura të Universitetit janë siguruar me një rrjetë nëntokësore-të jashtme hidrante e cila paraqet tërësinë e objekteve dhe aparateve me të cilat uji nga burimi për furnizim sillet në gypat përcjellës deri te lidhjet e hidrantëve të cilët përdoren për fikje të drejtpërdrejtë të zjarreve.

Numri i lidhjeve të hidrantëve dhe sasia e ujit është caktuar sipas shkallës së rezistencës MKS. U.J 1240 dhe kategorisë së procesit të punës sipas rrezikut nga zjarri.

Neni 55

Rreth objektit që mbrohet nga zjarri vendosen hidrantë mbitokësorë.

Hidrantët e jashtëm janë me diametër prej 80 mm ose 100 mm. Diametri i gypit përcjellës të mos jetë më i vogël nga 100 mm, kurse presioni minimal dinamik të mos jetë më i vogël nga 2.5 barë.

Hidrantët kanë qasje në çdo kohë. Ata shënohen me tabela, vendosen në atë mënyrë që të pengohet ngrirja ose dëmtimi i tyre. Çdo hidrant e ka dollapin e vet për vendosjen e pajisjes së nevojshme.

Në objektin 900 gjenden këto pajisje: zorrë f52 mm 15m (tip S) 4copë, gryka e currilit me ventil f52 -2copa, çelësi me lidhsën „C“ 1 copë dhe çelësi universal për lidhsa - A,B,C 1 copë dhe çelësi për hidrantin „T“ katërshe 24/34 1 copë.

Neni 56

Presioni i nevojshëm dhe sasia e ujit sigurohet nga rezervuari me aparatit për rritjen e presionit.

Aparati për rritjen e presionit është siguruar me burim rezervë të energjisë elektrike.

Neni 57

Rrjeta e hidrantëve duhet të vendoset në objekte ku uji përdoret si mjet për fikjen e zjarrit.

Neni 58

Një rrjetë e veçantë e jashtme me hidrantë nëntokësorë është vendosur në Universitet e cila është nën presion të vazhdueshëm nga 2,5 barë, kurse presioni më i lartë në rrjetën e hidrantëve nuk guxon të kalojë më shumë se 7 barë.

Neni 59

Një herë në vit bëhet kontrollimi për të parë a është në rregull tërë infrastruktura zjarrfikëse: Aparatet zjarrfikëse, rrjeta e hidrantëve, Hidrantët zjarrfikës dhe zorrët, grykat e currilave dhe ventilet tërthorëza dhe presioni në ta.

Njëherësh të bëhet kontrollimi i tokëzimit të aparateve elektrike. Kontrolli dhe verifikimi i rregullshmërisë së instalimit rrufefritës bëhet për çdo vjet, ndërsa, sipas nevojës, edhe më shpesh (në rast të dëmtimeve mekanike, lirimit eventual të pjesëve etj.).

Neni 60

Aparatet zjarrfikëse duhet të renditen në të gjitha vendet kritike e të dukshme dhe ato duhet të shënohen dukshëm me tabelë Aparate zjarrfikëse dhe mos të zhvendosen.

Aparatet zjarrfikëse duhet medoemos të vendosen në vend ku pa pengesa dhe shumë shpejt të mund të shfrytëzohen. Vendosja e tyre nuk guxon të jetë më e lartë se 1,5 m lartësi, duke llogaritur nga dyshemeja.

Kontrolli i brendshëm

Neni 61

Kontrollin e brendshëm e bën shërbimi për sigurim i Universitetit ose personi i caktuar për këtë punë për mbrojtje kundër zjarreve dhe i ka të drejtat dhe detyrimet vijuese:

- Bën kontroll të tërësishëm në zbatimin e pajisjes për krejt pajisjet dhe mjetet për mbrojtje nga zjarri.
- E kontrollon ruajtjen, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve për mbrojtje nga zjarri.
- Bën kontroll në hapësirat tjera për shkak të zbatimit dhe realizimit të dispozitave dhe masave preventive për mbrojtje nga zjarri, në përputhje me Vlerësimin dhe planin për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera dhe në përputhje me Elaboratin (Projektin) për mbrojtje nga zjarret, shpërthimet dhe materiet e rrezikshme.
- Propozon ndryshime dhe plotësime të Vlerësimit të rrezikimit dhe të Planit për mbrojtje dhe shpëtim dhe të Rregullores për mbrojtje nga zjarri dhe shpërthimet dhe të akteve të tjera nga kjo fushë.
- Në bazë të mangësive të vërtetuara në kuptim të mbrojtjes nga zjarri, më së paku njëherë në muaj bën procesverbal (lajmërim) për to dhe në të i paraqet masat dhe afatin për largimin e mangësive të paraqitura (vërejtjet, rekomandimet, afatin për largimin e tyre, propozime për sanksione dhe shpërblime etj.).

6. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRMBYLLËSE

Neni 62

Të gjithë të punësuarit dhe studentët në Universitet janë të detyruar t'u përmbahen dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe t'i zbatojnë masat e parapara për mbrojtje nga zjarri.

Neni 63

Për disa punë të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore do të vlejnjë dispozitat e Ligjit për zjarrfikës të RM.

Neni 64

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj.